




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



SHËRBIMI I PROVËS



Nr. 1203, prot.

Datë 02.12.2022

Nr. 6209/, prot.

Datë 09.12.2022

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

ndërmjet

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT TË PROVËS

dhe

BASHKISË DEVOLL

Sot më datë, _____. _____.2022, lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Palëve:

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës, me Adresë: Rruga "Jordan Misja", Ndërtesa 6/1, Hyrja 1, Kodi Postar 1016, Tiranë, përfaqësuar nga drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit të Provës z. Ervin Hoxha, këtu e në vijim "DPSHnP",

dhe

Bashkia Devoll, me Adresë: Lagjja Nr.1 Rruga "24 Tetori", Nr. 5, Devoll përfaqësuar nga kryetari z. Eduard Duro, këtu e në vijim "Bashkia".

Palët në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi bien dakord për nënshkrimin e saj si më poshtë:

Neni 1
Objekti i Marrëveshjes

Objekti i kësaj Marrëveshjeje konsiston në vendosjen e bashkëpunimit midis dy institucioneve për zbatimin e dënitit alternativ "kryerja e një pune në interes publik" për personat nën mbikëqyrje dhe të miturit në konflikt me ligjin me këtë lloj dënim, me qëllim mbrojtjen e interesave të komunitetit, parandalimin e kryerjes së veprave penale, asistimin e personit nën mbikëqyrje dhe të miturit në konflikt me ligjin gjatë kryerjes së dënitit alternativ për përbushjen e detyrimeve dhe kushteve që rrjedhin nga ky dënim, si dhe në kapërcimin e vështirësive për riintegrimin e tij shoqëror.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi bazohet në ligjin 37/2017, datë 30.03.2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur" në ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, në ligjin 79/2020 "Për Ekzekutimin e Vendimeve Penale", në ligjin nr. 78/2020 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit të Provës", në V.K.M nr. 421 datë 08.07.2021 "Për Miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Shërbimit të Provës", si dhe në ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

Neni 3
Qëllimi i Marrëveshjes

Kontributi i institucioneve për zbatimin e dënitit alternativ "kryerja e një pune në interes publik" për personat nën mbikëqyrje dhe të miturit në konflikt me ligjin me qëllim mbrojtjen e interesave të këtij komuniteti, parandalimin e kryerjes së veprave penale, asistimin e personit nën mbikëqyrje dhe të miturit në konflikt me ligjin gjatë kryerjes së dënitit alternativ për përbushjen e detyrimeve dhe kushteve që rrjedhin nga ky dënim, si dhe në kapërcimin e vështirësive për riintegrimin e tij shoqëror.

Neni 4
Detyrimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës

1. DPSHP, me anë të degës territoriale kompetente të Shërbimit të Provës, njofton Bashkinë, për personat nën mbikëqyrje dhe të miturit në konflikt me ligjin për punën që do të kryejnë, duke i vënë në dispozicion dokumentat përkatëse të nevojshme.
2. DPSHP, nëpërmjet degës territoriale kompetente të Shërbimit të Provës, garanton paraqitjen e specialistëve të degës territoriale, pranë Bashkisë dhe institucioneve të varësisë së saj, të pajisur me dokumentin identifikues të lëshuar nga institucioni, për realizmin e mbikëqyrjes së personit nën mbikëqyrje dhe të miturit në konflikt me ligjin gjatë ekzekutimit të vendimit për kryerjen e punës në interes publik.
3. DPSHP, nëpërmjet degës territoriale kompetente të Shërbimit të Provës, garanton se specialisti i Shërbimit të Provës në ushtrimin e veprimtarisë së tij do të udhëhiqet nga ndershmëria, paanësia dhe profesionalizmi.

Neni 5 **Detyrimet e Bashkisë**

1. Bashkia, nëpërmjet institucioneve të varësisë, merr përsipër të sigurojë vendin e punës ku do kryhet puna në interes publik (pa pagesë) nga personi nën mbikëqyrje dhe i mituri në konflikt me ligjin, me këtë dënim alternativ.
2. Bashkia, nëpërmjet institucioneve të varësisë, përcakton personin përgjegjës për të mbikëqyrur realizimin e punës nga personi nën mbikëqyrje dhe i muturi në konflikt me ligjin duke evidentuar orët e punës mbi bazat ditore.
3. Bashkia, nëpërmjet institucioneve të varësisë, merr përsipër që në përfundim të punës me interes publik të pajisë personin nën mbikëqyrje dhe të miturin në konflikt me ligjin, me një vërtetim mbi orët e punës dhe datat e kryerjes së saj.
4. Bashkia, nëpërmjet institucioneve të varësisë dërgon zyrtarisht një kopje të vërtetimit sipas pikës 3 të këtij nenit, pranë degës territoriale kompetente të Shërbimit të Provës, pasi ky institucion ka detyrimin të hartojë raportin përfundimtar në përfundim të dënitit alternativ nga personi nën mbikëqyrje dhe i mituri në konflikt me ligjin.
5. Bashkia merr përsipër të ndihmojë të mbikëqyrurin dhe të miturin në konflikt me ligjin, me dënimin alternativ "kryerja e një pune në interes publik" për përbushjen e detyrimeve dhe kushteve që rrjedhin nga ky dënim, si dhe në kapërcimin e vështirësive për riintegrin e tij shoqëror me qëllim mbrojtjen e interesave të komunitetit, parandalimin e kryerjes së veprave penale etj.
6. Bashkia, nëpërmjet institucioneve të varësisë garanton se personi nën mbikëqyrje dhe i mituri në konflikt me ligjin gjzon të drejta të njëjta me punëmarrësit e tjerë, lidhur me mbrojtjen e shëndetit dhe të sigurisë në punë, mirëqenien sociale dhe kohëzgjatjen e punës e të pushimit, si dhe çdo të drejtë të parashikuar nga legjislacioni në fuqi që rregullon marrëdhëniet e punës, me përjashtim të kufizimeve që rrjedhin nga natyra e dënitit dhe përbushja e detyrimeve të tij.
7. Bashkia, nëpërmjet institucioneve të varësisë kur konstaton mospërbushje të detyrimeve përkatëse nga personi nën mbikëqyrje. brenda 5 (pesë) ditëve i raporton Shërbimit të Provës, i cili njofton prokurorin.

Neni 6
Kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë të pacaktuar nga dita e nënshkrimit dhe do të jetë efektive përgjatë kësaj periudhe.

Neni 7
Personat e kontaktit

1. Secila nga palët përcakton një person kontakti të cilës/it i drejtohen të gjitha komunikimet, qofshin verbale apo të shkruara, si elektronike ashtu dhe të shtypura në letër. Në çastin e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje personat e kontaktit janë si në Aneksin 1.
2. Personat e caktuar në Aneksin 1, bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje, do të janë përgjegjës për saktësinë e protokolleve, proces - verbaleve, listave dhe çdo dokumenti shoqëruar që do të dalë në zbatim të Marrëveshjes.
3. Në rast të ndryshimit të njërit nga personat e caktuar në Aneksin 1, pala e cila përfaqësohet prej këtij personi, do të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese të dhënët e personit të ri të kontaktit brenda 1 (një) javë kalendarike nga data e ndryshimit, të cilat njëkohësisht do t'i bashkëlidhen Marrëveshjes nëpërmjet ankeseve.

Neni 8
Zbatimi i Marrëveshjes

1. Palët marrin përsipër zbatimin e kësaj Marrëveshjeje nga data e nënshkrimit të saj.
2. Për çdo problem gjatë zbatimit të Marrëveshjes, palët marrin përsipër të komunikojnë midis tyre për zgjidhjen me mirëkuptim të të gjitha mosmarrëveshjeve që mund të rrjedhin gjatë zbatimit të saj.
3. Çdo ndryshim i akteve ligjore e nënligjore, për aq sa ato lidhen me këtë Marrëveshje, do të reflektohet zyrtarisht në ndryshimin e saj.

Neni 9
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve zgjidhen me fryshtë e mirëkuptimit dhe me bisedime ndërmjet tyre.

Neni 10
Dispozita të fundit

1. Palët janë të detyruara të respektojnë këtë Marrëveshje për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar në Nenin 6 të saj.
2. Çdo palë merr përsipër të përbushë detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje pa pretendim financiar ndaj palës tjetër.

3. Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga të dyja palët.


4. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët dhe hartohet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, nga 2 (dy) kopje për secilën palë.

PËR

DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË
SHËRBIMIT TË PROVËS

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Ervin Hoxha



PËR

BASHKINË DEVOLL

KRYETARI

Eduard Duro

